

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-066/13

**Prishtinë,
1 tetor 2013**

Në çështjen juridike të

S. Đ

Paraqitësja e kërkesës/Pala ankuese

kundër

Z.U

Pala përgjegjëse në kërkesë/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, Anëtarë, në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK /D/A/149/2012 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA 35303), të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 1 tetor 2013, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e S.Đe.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës KKPK/D/A/149/2012, i datës 19 prill 2012, për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA 35303.
3. Obligohet pala ankuese që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë) në Buxhetin e Kosovës brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 19 prill 2007, S.Đ paraqiti një kërkesë si anëtare e familjes së ngushtë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri-posedimin e një ngastre që ndodhet në Deçan te vendi i quajtur Ratish e Ulët, ngastra nr. 46, me sipërfaqe prej 4 ha, 81 ari dhe 55 m². Ajo pretendoi se babai i ndjerë i saj S.Ć, i cili ndërroi jetë në vitin 2006, ishte bashkë-pronar i ngastrës me 1/3 të hises. Ajo pohoi se prona qe uzurpuar nga Z.U. i cili e kishte prerë malin në ngastër dhe e kishte shndërruar në tokë të punueshme. Ajo kërkon kompensimin për dëmin si dhe ri-posedimin.

Për ta mbështetur kërkesën e saj, paraqitësja e kërkesës dorëzoi në AKP këto dokumente:

- Fletën Poseduese nr. 72 (apo ndoshta 172, e palexueshme), të lëshuar nga Zyra Komonale e Gjeodezisë në Deçan më datën 09/02/1967;
- Një kopje të certifikatës së lëshuar nga Kuvendi Komunal i Deçanit Nr. 07-952/342 më datë 6 mars 1978;
- Vendimin e trashëgimisë të lëshuar nga Gjykata Komonale në Kraljevë, më datë 19/07/2006, që e tregon S.Ć (jo si Ć.) si njëra nga trashëgimtarët e S.C. me 1/5 të hises;
- Certifikatën e martesës së S.C. dhe V.Đ.;
- Certifikatën e vdekjes së S.Ć, të datës 08/10/2008;
- Dëshmitë tatimore të datës 06/03/1978.

AKP verifikoi në mënyrë pozitive dokumentet që dëshmojnë marrëdhënien e paraqitëses së kërkesës me bartësin e së drejtës së pronës.

Raporti njoftues i AKP-së i datës 5 nëntor 2010 pasqyron llojin e tokës si pyll që është zënë nga Z.U. Z.U., ndonëse pretendoi se ka të drejta ligjore mbi pronën, refuzoi që ta nënshkruaj njoftimin e pjesëmarrjes.

Sipas raportit verifikues të AKP-së, të datës 21/07/2011, pas fotografimit ajror, ngastra me numër 46 është rinumëruar si ngastra nr.126 dhe është e regjistruar në fletën poseduese numër 50, e regjistruar në emër të Ć.N. (M.). Po ashtu është vërejtur se mbiemri i pronarit të regjistruar është shënuar gabimisht si Shulatish por që do të duhej të ishte Ć..

Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së kontaktoi paraqitësen e kërkesës pasi gjeti se ngastra e pretenduar ishte e regjistruar në emër të N.Ć. Sipas Aneksit të Raportit për Procedimin e Kërkesës të KKPK-së të datës 23 mars 2012, paraqitësja e kërkesës deklaroi se N.Ć. është xhaxhai i saj i cili i ka regjistruar të gjitha ngastrat në emrin e tij në kadastër, ndërsa ka pasur kontest familjar rreth ngastrës së pretenduar. Asaj nuk i kujtohej kur kishte ndodhur ky ndryshim apo nëse babai i saj ka mundur t'ia shes këtë pronë xhaxhait të saj; megjithatë, ajo konfirmoi se ndryshime të tilla kishin ndodhur para një kohe të gjatë ngase ajo ishte larguar nga Kosova me familjen e saj në vitin 1982. Ajo gjithashtu konfirmoi se nuk e kishte humbur posedimin e ngastrës në vitin 1999 dhe se nuk kishte ndonjë dokument tjetër për ta dorëzuar lidhur me pronën.

Më 19 prill 2012, KKPK me vendimin e vet KKPK/D/A/149/2012 hodhi poshtë kërkesën në mungesë të juridiksionit. KKPK deklaroi se paraqitësja e kërkesës dorëzoi fletën poseduese nr. 172 (apo 72- nuk është e qartë nga kopja e fletës poseduese) të vitit 1967; megjithatë, Sekretariati Ekzekutiv *ex officio* gjeti se ngastra e pretenduar ishte jo vetëm e rinumëruar dhe e shënuar në fletën poseduese nr.50, por se ishte gjithashtu e shënuar në emër të xhaxhait të paraqitëses së kërkesës. KKPK u mbështet në faktet se paraqitësja e kërkesës pranoi se kishte ekzistuar një kontest i kamotshëm familjar rreth ngastrës dhe se ajo ishte larguar nga Kosova në vitin 1982, dhe se xhaxhai i saj më pas i kishte regjistruar të gjitha ngastrat në emrin e tij. Komisioni arriti në konkludimin se paraqitësja e kërkesës e kishte humbur posedimin si rrjedhojë e kontestit familjar dhe në këtë mënyrë vendosi se kërkesa ishte jashtë kompetencave të veta. KKPK më tej theksoi se Pala përgjegjëse në kërkesë (Z.U.), i cili fillimisht pretendoi të drejta ligjore mbi ngastrën, shpjegoi se ai nuk e përdor pronën e pretenduar më dhe se prona ishte shitur nga fëmijët e xhaxhait të paraqitëses së kërkesës njërit prej fqinjëve të tij.

Vendimi iu dërgua paraqitëses së kërkesës më 4 dhjetor 2012. Më 4 janar 2013, ajo paraqiti një ankesë. Ajo kërkoi që të merret një vendim i ri dhe të lirohet nga pagesa e të gjitha taksave pasi që nuk ka të

ardhura dhe vuan nga një sëmundje kronike. Ajo nuk paraqiti ndonjë dokument për ta mbështetur kërkesën e saj për lirim nga shpenzimet.

Vendimi iu dërgua Z.U. më 24 prill 2013. Z.L. (Sekretaria Ekzekutive i referohet atij si i biri i U.) u përgjigj në ankesë më 7 maj 2013, duke cekur ai nuk dinte asgjë rreth pronës dhe se ai nuk kishte blerë asgjë nga këta njerëz të cilët e kishin paraqitur këtë çështje kundër tij. Ai më tej theksoi se nuk dëshironte të ftohej në lidhje me këtë lëndë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është paraqitur me kohë. Ajo është e pranueshme por jo e bazuar.

Gjykata Supreme pajtohet me gjetjet e KKPK-së se kërkesa nuk është nën juridiksionin e KKPK-së.

Kjo është për shkak se sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësja e kërkesës ka të drejtë për një urdhër nga Komisioni për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësja e kërkesës dëshmon jo vetëm pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, por edhe se ai apo ajo tani nuk është në gjendje t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

Nën dritën e fakteve të vërtetuara, posedimi i pronës ishte humbur për shkak të një kontesti të kamotshëm familjar që kishte ndodhur para konfliktit, sikurse pohon paraqitësja e kërkesës. Paraqitësja e kërkesës si njëra nga trashëgimtarët e të ndjerit S.Ć. pretendon 1/5 e hiseve të hises së të atit (gjoja se arrin në 1/3 e tërë ngastrës si njëri prej bashkë-pronarëve) në ngastrën e kërkuar. Ajo u largua nga Kosova në vitin 1982 dhe konfirmoi se nuk e kishte humbur posedimin në vitin 1999. Është e qartë nga dokumentet dhe deklaratat në shkresat e lëndës së AKP-së se kontesti rreth asaj se kush e kishte të drejtën për regjistrimin e pronës në fjalë kishte filluar shumë më herët para shpërthimit të konfliktit të armatosur në vitet 1998/1999. Kontesti as nuk është shkaktuar e as nuk është ndikuar nga lufta. Kontesti buron drejtpërdrejtë nga një mosmarrëveshje pronësore ndërmjet anëtarëve të familjes Ć. dhe nuk përmban asnjë aspekt të një kërkesë që mund të ndërlidhet me konfliktin. Prandaj, kërkesa është jashtë juridiksionit të AKP-së dhe KKPK-së. Konkludimi i KKPK-së që hodhi poshtë kërkesën në mungesë të juridiksionit ishte i drejtë. Rrjedhimisht, sipas nenit 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ankesa është dashur të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i KKPK-së sa i përket lëndës për të cilën është dashur të vendoset në këtë aktgjykim (AKP 35303).

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhëresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit::

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (10.21, 10.15 dhe 10.1 e UA 2008/2): € 30

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Pala ankuese nuk ka paraqitur ndonjë dokument për ta mbështetur deklaratën e vet se nuk ka mjete financiare. Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Neni 47.3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Paraqitësja e kërkesës mund të kërkojë zgjidhje për ngastrën në fjalë para gjykatës kompetente themelore.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it